

Viti akademik 2020-2021

Qeveria miraton për herë të parë 9 bursa për studentët me origjinë shqiptare



Këshilli i Ministrave ka vendosur në mbledhjen e radhës akordimin e 9 bursave të studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, propozim i paraqitur nga Ministri i Shtetit për Diasporën. Sipas vendimit nëntë bursat për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për vitin akademik 2020-2021 përfshijnë mbulimin financiar për tarifën e studimeve, si dhe shpenzimet e akomodimit e të ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik të cilat do të përballohen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare për Diasporën. Me qëllim mësimin dhe thellimin e njohurive të gjuhës së origjinës do të përfitojnë tre bursa studentët e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina, dy bursa studimi shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit Arbëresh në Itali, dy bursa studimi shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci dhe dy bursa studimi shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgaria. Agjencia Kombëtare e Diasporës do të kryejë pagesat e mësuesve të nevojshëm për mësimin e gjuhës shqipe në vitin e parë të studimeve për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2020-2021.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore këtu:

“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”



“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Regjistrimi i votuesve nga Diaspora, Ministri Majko takim me institucionet



Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko ka zhvilluar një takim online me përfaqësues të institucioneve të Ministrisë së Brendshme dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) të cilët do të realizojnë procesin e regjistrimit të adresave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë dhe regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit dhe do të shprehin dëshirën për të marrë pjesë në zgjedhjet në Shqipëri. Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me këto dy procese të cilat janë të ndryshme dhe të pavarura nga njëra-tjetra. Regjistrimi i adresave të shtetasve shqiptarë jashtë vendit do të realizohet nëpërmjet një sistemi, ku personat e do të identifikohen dhe do të kenë mundësi të ndjekin të gjitha hapat e procesit. Vlen të theksohet se ky nuk është një regjistrim detyrues, por një mënyrë për tu identifikuar dhe për të përfutur shërbimet e shtetit shqiptar.

Emërohen për herë të parë katër oficerë koordinues për Diasporën në Itali dhe Greqi

Komunitetet shqiptare në Greqi dhe Itali për herë të parë në historinë e Diasporës së re do të kenë oficerë koordinues për çështjet e Diasporës shqiptare pranë posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë në Romë, Athinë, Milano dhe Selanik. Propozimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave parashikon vendosjen e katër oficerëve koordinues të cilët do të merren me çështjet e Diasporës shqiptare në fushën e kulturës, arsimit, financës dhe drejtësisë. Oficerët koordinues do të ushtrjnë funksionin e tyre sipas fushave të përcaktuara si: zhvillimi i marrëdhënieve me komunitetet shqiptare në shtetin pritës, kjo në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, identifikimin e nevojave për arsimimin dhe komunikimin me mësuesit e programeve plotësuese të gjuhës e të kulturës shqiptare në bashkëpunim me Qendrën e Botimit të Diasporës, nxitjen dhe organizimin e bizneseve shqiptare në vendin pritës në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës si dhe identifikimin dhe asistimin e shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me heqje të lirisë në shtetin pritës në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për drejtësinë.



Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Miratohet Urdhri Nr.103 për

“Ngritjen e komisionit të veçantë për vlerësimin e rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë”



Me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë miraton urdhrin për “Ngritjen e komisionit të veçantë për vlerësimin e rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë”. Në përbërje të këtij komisioni janë 8 persona përfaqësues. Komisioni bazohet në informacionin për studentët, shtetas të Republikës së Shqipërisë të cilët studiojnë jashtë vendit dhe për studentët, shtetas të huaj me origjinë shqiptare, të cilët kanë përfutur bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, në shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës. Komisioni mbledhet të paktën 3 (tre) herë në vit ose jashtë radhës me kërkesën e kryetarit të tij.

Aplikacioni Gazeta “Diaspora Shqiptare”



App store këtu: Play store këtu:

FSHZHD dhe Biblioteka Kombëtare marrëveshje bashkëpunimi për Digjitalimin e Veprave Shqiptare



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, dhe Ministri i Shtetit për Diasporën kanë firmosur një marrëveshje me qëllim bashkëpunimin për realizimin e aktiviteteve për zhvillimin dhe promovimin e kulturës kombëtare në komunitetet shqiptare jashtë vendit. Kjo marrëveshje parashikon koordinimin e veprimtarisë së institucioneve duke i dhënë rëndësi të veçantë kërkimit, hulumtimit dhe studimit të mundësive për ruajtjen, përhapjen dhe promovimin në Diasporën shqiptare të kulturës shqiptare në përgjithësi, si dhe gjuhës e letërsisë shqipe në veçanti. Në bazë të kësaj marrëveshjeje këto institucione do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për zhvillimin dhe promovimin e platformës “Digjitalimi i Veprave Shqiptare”, organizimin e veprimtarive të përbashkëta kulturore për gjuhën, letërsinë, kulturën dhe vlerat shqiptare në komunitetet shqiptare jashtë vendit (konferenca, seminare, ekspozita etj.), që synojnë vlerësimin e trashëgimisë kulturore të Diasporës shqiptare.

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store këtu: Play store këtu:

QBD siguron falas platformën digjitale për mësuesit e gjuhës shqipe në Diasporë

Qendra e Botimeve për Diasporën, në kuadër të fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021, rikujton të gjithë mësuesit e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë, që për të lehtësuar procedurën e mësimdhënies, ajo ka siguruar për ta akses falas për një vit, në Platformën Digjitale të Mësimdhënies “Schoolme”. QBD-ja është përkushtuar në plotësimin e nevojave të mësuesve të gjuhës e kulturës shqiptare në Diasporë, për mësimdhënien, rritjen e cilësisë së saj dhe lehtësimin e procedurave lidhur me Risia e këtij viti është seria e botimeve dygjuhëshe nga vetë QBD-ja

QBD nis tekste në Itali dhe Ukrainë, mbyllet procesi i dërgimit në 22 shtete

Qendra e Botimeve për Diasporën ka mbyllur në një kohë rekord, procesin e rëndësishëm të përpunimit dhe shpërndarjes së teksteve mësimore dhe librave plotësues për shkollat shqipe në Diasporë. Në përmblyllje ishte radha e Italisë dhe Ukrainës në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropën nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko. Qendra e Botimeve për Diasporën ka përgatitur posaçërisht dhe fjalorin shqip-italisht, serinë e përrallave klasike shqip-italisht për një mësimdhënie sa më argëtuese dhe ftuese për fëmijët në Itali. Dhe së fundmi, drejt Ukrainës, ku gjendet një ndër komunitet më të vjetra shqiptare. Komuniteti shqiptar i Ukrainës ka ngjallur një interes të shtuar tek albanologët dhe studiuesit, për gjuhën e zhvillimin e tyre historik. Për të qenë sa më pranë tyre, veç të tjerash, Qendra e Botimeve për Diasporën, kushtuar këtij komuniteti, ka botuar “Fjalorin dygjuhësh për fëmijë shqip-ukrainisht”. Mbi 17 mijë tekste shkollore dhe plotësuese do të mbërrijnë brenda muajit shtator te nxënësit dhe mësuesit e shkollave të gjuhës dhe kulturës shqiptare të 22 vendeve të botës, për vitin 2020-2021.

